

Mini KASKO



POLICA E SIGURIMIT MINI-KASKO

Sigurimi Mini-Kasko është sigurimi i vetë mjetit motorrik brenda territorit të Republikës së Kosovës, për dëmtimet materiale të vetë mjetit motorrik vetëm nga përplasja në rrugë e tij me një mjet tjetër motorrik të identifikuar dhe vërtetuar me raportin e policisë për ngjarjen e sigurimit, si dhe me foto të mjeteve të përfshira në aksident dhe të vendit të ngjarjes.

1. Polica Mini-Kasko është e vlefshme:

- a. Vetëm në territorin e Republikës së Kosovës,
- b. Vetëm për një vit nga data e hyrjes në fuqi të policisë.
- c. Vetëm për një ngjarje sigurimi në vit (mbulon vetëm një aksident).
- d. Vetëm për përplasjen në rrugë të mjetit të siguruar Mini-Kasko me një mjet tjetër motorrik të identifikuar, vërtetuar kjo me raportin e Policisë si dhe me foto të mjeteve të përfshira në aksident dhe vendit të ngjarjes.
- e. Vetëm për përdoruesit e mjetit të shënuar në Policën Mini-Kasko. Nëse drejtuesi i mjetit në momentin e aksidentit nuk e ka emrin në Police si përdorues mjeti, atëherë nuk përfiton nga sigurimi Mini-Kasko.

2. **Shuma e siguruar** është e përcaktuara në policën e sigurimit sipas vlerës së tregut të mjetit, por jo me shumë se 5.000 Euro, pavarësisht nëse mjeti ka një vlerë më të madhe.

Si duhet të veproni në rast dëmi?

1. [Njoftoni aksidentin në numrin e emergjencës 192 ose 112](#)
2. [Bëni 3-4 foto dixhitale të mjeteve të përfshira në vendngjarje dhe të vendit të ngjarjes](#)
3. [Njoftoni Degën/Agjencinë më të afërt të SIGAL UNIQA.](#)
4. [Merr një kopje të proces-verbalit të policisë:](#)
5. [Mos riparoni mjetin pa njoftuar dhe pa marrë me parë miratimin e SIGAL UNIQA](#)
6. [Përgatitni dosjen e dëmit dhe dorëzoheni tek një Degë e SIGAL UNIQA, së bashku me policën origjinale MINIKASKO](#)